



PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

Ligji Nr. 02/L-40

PËR PROVIMIN E JURISPRUDENCËS

Kuvendi i Kosovës,

Në mbështetje të Kreut 5.3 (dh), 5.7 dhe 9.1.26 (a) të Kornizës Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë (Rregullorja e UNMIK-ut, 2001/9 e datës 15 maj 2001),

dhe me qëllim që provimi i Jurisprudencës të zhvillohet dhe zbatohet në pajtueshmëri të plotë me Ligj, dhe përvojën më të mirë ndërkombëtare,

Miraton:

LIGJIN PËR PROVIMIN E JURISPRUDENCËS

KREU I
DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Qëllimi i dhënies së provimit të jurisprudencës
Neni 1

1.1. Me këtë ligj përcaktohen kushtet, kriteret dhe procedurat për dhënien e provimit të jurisprudencës me të cilin juristët e diplomuar fitojnë të drejtën për ushtrimin e punëve dhe detyrave profesionale në mënyrë të pavarur, kryerja e të cilave kushtëzohet me dhënien e provimit.

1.2. Qëllimi i provimit të jurisprudencës është verifikimi dhe vlerësimi i aftësive teorike dhe praktike të juristëve për ushtrimin e pavarur të detyrave, zbatimin e ligjeve, njohjen e etikës profesionale, të drejtat e njeriut, dhe liritë themelore nga e drejta e brendshme dhe ajo ndërkombëtare.

Kushtet e përgjithshme për dhënien e provimit të jurisprudencës
Neni 2

2.1. Personat të cilët mund t'i nënshtrohen provimit të jurisprudencës duhet të jenë të diplomuar në Fakultetin Juridik, sipas programit të vjetër katër vjeçar ose studimet master, pa dallim race, ngjyre, feje, gjinie, opinioni politik, origjinë kombëtare, sociale, pasurie, lindjeje ose pozite.

2.2. Të gjithë kandidatët që i nënshtrohen provimit të jurisprudencës do të vlerësohen në mënyrë të barabartë dhe me të njëjtat kriteret.

2.3. Kandidatët që i nënshtrohen këtij provimi duhet të jenë qytetarë të Kosovës.

Kushtet e veçanta për dhënien e provimit të jurisprudencës
Neni 3

3.1. Provimit të jurisprudencës kanë të drejtë t'i nënshtrohen juristët e diplomuar sipas programit të vjetër katër vjeçar, ose studimet master që kanë punuar, së paku një (1) vjet në punët juridike në gjykata, prokuroritë publike, ose në zyret e avokatit, si dhe ata që kanë punuar së paku dy (2) vite në punët profesionale juridike në institucione, ente, e organizata tjera, që kanë të bëjnë me zbatimin e ligjeve.

3.2. Provimit të Jurisprudencës i nënshtrohen edhe juristët e diplomuar, sipas programit të vjetër katër vjeçar dhe studimit master të cilët nuk janë në marrëdhënie pune të rregullt por vullnetarisht kanë ushtruar si praktikant dhe janë regjistruar në regjistrat e Odës së Avokatëve për praktikantë, përkatësisht që me vendimin për ushtrimin e praktikës vullnetare për një (1) vit nga Gjykatat, Prokuroritë publike, zyret e avokatëve si dhe ata që dy (2) vite kanë ushtruar praktikë në profesion të juristit në institucione, ente dhe organizata tjera.

3.3. Juristet e diplomuar të cilët kanë dhënë provimin profesional për punë në organet e administratës si dhe ata që kanë dhënë provimin profesional të gjygtarit për kundërvajtje, provimin e judikaturës e japin si provim plotësues, sipas programit të shkurtuar, konform dispozitave paraprahe, duke iu pranuar provimet e dhëna.

3.4. Provimi i Jurisprudencës iu pranohet të gjithë atyre juristëve të diplomuar sipas programit të vjetër katër vjeçar ose studimet master e të cilët kanë arritur gradën shkencore : Magjistër apo doktor shkence nga lëmia e drejtësisë.

Lëndët e provimit të jurisprudencës
Neni 4

4.1. Provimi i jurisprudencës përbëhet nga pjesa e provimit me shkrim dhe pjesa e provimit me gojë.

4.2. Në pjesën e provimit me shkrim, zgjidhen detyra praktike nga e Drejta Penale dhe e Drejta Civile.

4.3. Pjesa me gojë e provimit përbëhet nga këto lëndë:

- a) Sistemi kushtetues dhe organizimi i jurisprudencës,
- b) E Drejta Penale (materiale dhe procedurale),
- c) E Drejta Civile (materiale, procedurale), familjare, trashëgimore dhe detyrimore),
- d) E drejta tregtare (ekonomike),
- e) E drejta e punës,
- f) E drejta administrative dhe
- g) E drejta ndërkombëtare dhe Evropiane për të drejtat e njeriut.

Lëndët sipas programit të shkurtuar
Neni 5

5.1. Provimi i jurisprudencës sipas programit të shkurtuar përbëhet nga pjesa e provimit me shkrim dhe pjesa e provimit me gojë. Në pjesën e provimit me shkrim, zgjidhen detyra praktike nga e Drejta Penale dhe e Drejta Civile.

5.2. Personat nga neni 3.3 të këtij ligji, provimit me gojë i nënshtrohen sipas programit të shkurtuar nga këto lëndë:

- a) Organizimi i jurisprudencës (duke përjashtuar pjesën e Sistemit Kushtetues)
- b) E Drejta Penale (materiale, procedurale)
- c) E Drejta Civile (materiale, procedurale), familjare, trashëgimore dhe detyrimore)
- d) E drejta tregtare (ekonomike) dhe
- e) E drejta ndërkombëtare dhe evropiane për të drejtat e njeriut.

KREU II PËRBËRJA DHE MËNYRA E PUNËS SË KOMISIONIT PËR DHËNIEN E PROVIMIT TË JURISPRUDENCËS

Komisioni për dhënien e provimit të jurisprudencës Neni 6

6.1. Komisioni për dhënien e provimit të jurisprudencës, është organ i pavarur profesional i cili organizon provime për kualifikimin e gjyqtarëve, prokurorëve, juristëve dhe specialistëve të tjerë ligjor sipas Kreut 5.3 (dh) të Kornizës Kushtetuese.

6.2. Komisionin për dhënien e provimit të jurisprudencës sipas paragrafit 1 të këtij neni e emëron Kuvendi i Kosovës me propozim të Ministrisë së Drejtësisë.

6.3. Komisioni për punën e vet i raporton së paku një herë në vit Kuvendit të Kosovës.

Përbërja dhe mandati i Komisionit për dhënien e provimit të jurisprudencës Neni 7

7.1. Komisioni përbëhet nga kryetari dhe gjashtë anëtarë.

7.2. Kryetarit të Komisionit dhe anëtarëve u caktohen zëvendësit.

7.3. Komisioni emërohet nga radhët e juristëve të diplomuar të cilët e kanë të dhënë provimin e jurisprudencës ekspert të drejtësisë dhe nga radha e profesorëve të Fakultetit Juridik të cilët me punën e tyre në shkencë dhe në organet e jurisprudencës janë treguar si ekspertë të dalluar.

7.4. Komisioni vendos me shumicë votash.

7.5. Mandati i Komisionit zgjat dy vjet, gjysma e anëtarëve mund të emërohen edhe një mandat për shkak të kontinuitetit të punës.

7.6. Me vendim mbi emërimin e Komisionit do të caktohet se cilat lëndë do të pyet kryetari i Komisionit e cilat lëndë anëtarët e Komisionit përkatësisht zëvendësit. Pyetës i lëndës mund të jetë anëtari i Komisionit i cili lëndën e ka specializim të ngushtë, ka gradë shkencore nga ajo lëndë (psh. Mr.sci. ose Dr.sci.) ose ka përvojë pune pa ndërprerje 10 vjet si gjyqtar i lëndës.

7.7. Me të njëjtin vendim emërohet sekretari i Komisionit dhe zëvendësi i tij, i cili i kryen punët administrative të Komisionit.

KREU III DHËNIA E PROVIMIT

Kërkesa për dhënien e provimit Neni 8

- 8.1. Kërkesa për dhënien e provimit të jurisprudencës bëhet në Ministrinë e Drejtësisë-Departamentin e Administratës Gjyqësore (në tekstin e mëtejme: DAGJ-i).
- 8.2. Kandidatët në kërkesë cekin se në cilën gjuhë zyrtare dëshirojnë t'i nënshtrohen provimit dhe se a i janë nënshtruar provimit më parë.
- 8.3. Bashkë me kërkesën kandidati paraqet dëshminë mbi fakultetin e kryer juridik dhe dëshminë mbi përvojën në punë pas diplomimit.
- 8.4. Për dhënien e provimit sipas programit të shkurtuar kandidati është i obliguar që përveç dëshmive nga paragrafi paraprak të bashkëngjis dhe dëshminë për provimin e dhënë profesional për punë në organe të administratës, përkatësisht dëshminë mbi dhënien e provimit të gjyqtarit për kundërvajtje.
- 8.5. Kandidatët të cilët e kanë kryer Fakultetin Juridik në ndonjë universitet tjetër jashtë Kosovës, janë të obliguar që para se ta paraqesin provimin ta bëjnë nostrifikimin e diplomës së Fakultetit Juridik në Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, si dhe të sjellin dëshminë me të cilën vërtetohet se diploma e tyre është ekuivalente me diplomën e juristit të diplomuar sipas programit të vjetër katër vjeçar të studimeve ose të juristit që ka mbaruar studimet master.
- 8.6. Vendimi, me të cilin personit nga paragrafi 1 i këtij neni, i lejohet apo nuk i lejohet kërkesa për dhënien e provimit e lëshon komisioni përkatës i DAGJ-it.

Dhënia e provimit me shkrim Neni 9

- 9.1. Kohën e mbajtjes së provimit me shkrim e cakton kryetari i Komisionit për dhënien e provimit të jurisprudencës dhe në ditën kur kandidati i nënshtrohet pjesës së provimit me shkrim, konsiderohet se ka filluar dhënien e provimit. Dhënia e provimit të jurisprudencës organizohet në çdo katër muaj, gjegjësisht tri (3) herë brenda një (1) viti kalendarik. Lartësia e pjesëmarrjes financiare për paraqitjen (dhënien) e provimit të jurisprudencës përcaktohet nga Ministria e Drejtësisë.
- 9.2. Në pjesën e provimit me shkrim patjetër merr pjesë anëtari i komisionit që pyet lëndën e cila jepet me shkrim dhe sekretari i komisionit.
- 9.3. Gjatë hartimit të detyrave me shkrim, kandidati mund të shërbehet vetëm me tekstet e dispozitave ligjore (pa koment).
- 9.4. Pas kumtimit të detyrës, koha për zgjidhjen e detyrës me shkrim zgjatë 5 orë.
- 9.5. Vendimin për suksesin e arritur në provim me shkrim e miraton Komisioni, me shumicë votash pas marrjes së mendimit nga anëtarët e Komisionit të cilët i kanë kontrolluar punimet me shkrim.
- 9.6. Punimet me shkrim vlerësohen me “kalon me sukses të dalluar”, ”kalon” dhe “nuk kalon”.

Dhënia e provimit me gojë
Neni 10

10.1. Kandidati i cili kalon pjesën me shkrim të provimit nga lëmia penale dhe lëmia civile ose njërën prej tyre, i lejohet t'i nënshtrohet pjesës së provimit me gojë.

10.2. Kandidatit i cili në pjesën me shkrim të provimit, vlerësohet se "nuk ka dhënë provimin", nga ndonjëra lëndë, nuk do të i lejohet që t'i nënshtrohet pjesës së provimit me gojë nga ajo lëndë.

10.3. Provimin me gojë kandidatët e japin publikisht para Komisionit në përbërje të plotë.

10.4. Komisioni me shumicë votash do ta vlerësojë kandidatin sipas rezultatit që ka arritur në pjesën me shkrim dhe me gojë të provimit me "ka kaluar me sukses të dalluar", "ka kaluar" ose "nuk ka kaluar".

Kur konsiderohet se kandidati nuk e ka kaluar provimin
Neni 11

11.1. Kandidati i cili "nuk kalon" pjesën me shkrim të provimit nga lëmia penale dhe lëmia civile konsiderohet se "nuk ka dhënë provimin".

11.2. Kandidati i cili në nënshttrimin e parë të provimit nuk tregon sukses në tri e më shumë lëndë konsiderohet se "nuk e ka dhënë provimin".

11.3. Kandidati i cili në riprovim nuk tregon sukses së paku nga një lëndë, konsiderohet se "nuk e ka dhënë provimin".

11.4. Kandidati i cili pas nënshtimit të pjesës së provimit me shkrim, nuk e dorëzon detyrën, apo në mënyrë të heshtur nuk i nënshtrohet pjesës së provimit me gojë, konsiderohet se "nuk e ka dhënë provimin".

11.5. Kandidati i cili nuk paraqitet në riprovim në afatin prej dy deri në gjashtë muaj ose kandidati i cili nuk paraqitet për vazhdimin e provimit të shtyre (prolonguar) jo më vonë se tre muaj, konsiderohet se "nuk e ka dhënë provimin".

Mbetja në riprovim e kandidatit
Neni 12

12.1. Kandidati i cili nuk tregon sukses të kënaqshëm në një ose dy lëndë mbetet në riprovim.

12.2. Kandidati mund të mbetet në riprovim në të drejtën penale ose të drejtën civile dhe në një nga lëndët tjera.

12.3. Afati për dhënien e riprovimit nuk mund të jetë më i shkurtër se dy muaj dhe as më i gjatë së gjashtë muaj duke llogaritur nga data kur kandidati ka mbetur në riprovim.

12.4. Nëse kandidati nuk i nënshtrohet riprovimit në afatin prej dy deri në gjashtë muaj ose gjatë riprovimit nuk tregon sukses të kënaqshëm do të konsiderohet se "nuk ka dhënë provimin".

12.5. Kandidatët që mbesin në riprovim në pjesën me gojë nga e Drejta Penale ose e Drejta Civile e të cilët më parë kanë kaluar pjesën me shkrim të provimit, me rastin e riprovimit nuk do t'i nënshtrohen sërish pjesës me shkrim të provimit.

12.6. Kandidati i cili i nënshtrohet provimit sipas nenit 3.3 të këtij ligji në riprovim mund të mbetet vetëm nga një lëndë.

Shtyrja e provimit të filluar Neni 13

13.1. Provimi i filluar mund të shtyhet me kërkesën e kandidatit, nëse kandidati sëmuret, përjeton ndonjë aksident, i ndodh ndonjë rast vdekje në familje të ngushtë ose kur për ndonjë arsye të ngjashme nuk mund ta vazhdojë provimin.

13.2. Për shtyrjen e provimit të filluar vendos kryetari i Komisionit në bazë të dëshmive të cilat duhet t'i prezantojë kandidati.

13.3. Afati brenda të cilit kandidati duhet t'i nënshtrohet provimit të shtyrë nuk mund të jetë më i gjatë se tre (3) muaj nga data e shtyrjes.

13.4. Në vazhdim të provimit të shtyre kandidati u nënshtrohet vetëm provimeve të cilave nuk u është nënshtruar para shtyrjes së provimit.

Mosparaqitja për dhënien e provimit Neni 14

Kandidati i cili nuk paraqitet për dhënien e provimit në kohën e caktuar dhe kandidati i cili para fillimit të provimit heq dorë nga paraqitja në provim konsiderohet se nuk i është paraqitur në provim.

Mbrojtja e të drejtave të kandidatit Neni 15

15.1. Kandidati i cili konsideron se suksesi i përgjithshëm ose suksesi nga njëra lëndë nuk i është vlerësuar në mënyrë të drejtë, mund t'i parashtrijë ankesë Komisionit, brenda tri ditë pune, nga komunikimi i rezultatit të provimit.

15.2. Komisioni është i detyruar që brenda afatit prej pesë ditë pune ta shqyrtojë parashtrësën dhe lidhur me të ta njoftojë kandidatin.

15.3. Nëse parashtrësja e kandidatit aprovohet, Komisioni mund ta përsërisë provimin.

KREU IV NËNSHTRIMI I SERISHËM I PROVIMIT TË JURISPRUDENCËS

Përsëritja e provimit Neni 16

16.1. Kandidati i cili vlerësohet nga Komisioni provues se “nuk e ka dhënë provimin” mund ta përsërisë dhënien e provimit brenda afatit i cili nuk mund të jetë më i shkurtër se gjashtë muaj nga data kur i është komunikuar nga Komisioni se “nuk e ka dhënë provimin”.

16.2. Kandidati i cili nuk e jep provimin për të dytën herë, mund ta përsërisë dhënien e provimit brenda afatit i cili nuk mund të jetë më i shkurtër se 12 muaj.

KREU V
CERTIFIKATA MBI PROVIMIN E DHËNË TË JURISPRUDENCËS
DHE ÇËSHTJET TJERA LIDHUR ME PROVIMIN

Dhënia e certifikatës
Neni 17

17.1. Kandidatit që e ka dhënë provimin e jurisprudencës i lëshohet certifikata për provimin e dhënë të jurisprudencës.

17.2. Formën dhe përmbajtjen e certifikatës për provimin e dhënë të jurisprudencës e përcakton Ministri i Ministrisë së Drejtësisë.

KREU VI
DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE
Neni 18

18.1. Kandidati i cili ka filluar dhënien e provimit të jurisprudencës sipas dispozitave të Ligjit mbi provimin e judikaturës (“Gazeta zyrtare e Kosovës” nr. 10/77) dhënien e provimit do ta përfundojnë sipas dispozitave të këtij ligji.

18.2. Me provimin e jurisprudencës, në kuptim të këtij ligji, barazohet provimi i dhënë i jurisprudencës sipas dispozitave, të cilat kanë qenë të vlefshme deri me zbatimin e këtij ligji.

18.3. Kandidatët të cilët e kanë fituar të drejtën për t’iu nënshtruar provimit sipas dispozitave të cilat kanë qenë të vlefshme deri me zbatimin e këtij ligji, u mundësohet nënshtrimi i provimit edhe pas zbatimit të ligjit të ri.

18.4. Praktikantët të cilët deri në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji kanë filluar punën për përmbushjen e kushtit ligjor për t’iu nënshtruar provimit të jurisprudencës, provimit do t’i nënshtrohen sipas dispozitave të këtij ligji.

Neni 19

Në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji shfuqizohet Ligji mbi provimin e judikaturës (“Gazeta zyrtare e Kosovës” nr. 10/77).

Neni 20

Ministria e Drejtësisë nxjerr udhëzime administrative mbi mënyrën e punës së Komisionit për dhënien e provimit të jurisprudencës dhe të Komisionit të Ankesave, përmbajtjen e programit të provimit, përmbajtjen procesverbalit, evidencën lidhur me kandidatët që kanë dhënë provimin, shumën të cilën kandidati paguan për provim, kompensimin për punën e Komisionit, si dhe akte përkatëse nënligjore.

Hyrja në fuqi e ligjit
Neni 21

Ky ligj hyn në fuqi pas miratimit nga ana e Kuvendit të Kosovës dhe shpalljes nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm.

Ligji Nr. 02/L-40
20 janar 2006

Kryetari i Kuvendit të Kosovës,

akademik Nexhat Daci